




Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Gjakovica



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01 Nr. Br. 011-11265
07.07.2014



RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE TË KOMUNËS

Gjakovë, Korrik /2014

Në bazë të nenit 12 pika c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03L-040 (Gazeta Zyrtare e R. Kosovës nr. 28 e dt. 04.06.2008), nenit 36 të Rregullës Financiare nr.01/2013- Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimit Administrativ nr.06/2005 për rregullimin e procedurave të përkrahjes financiare familjeve dhe individëve në raste të jashtëzakonshme të dt: 01.01.2005 dhe nenit 18.2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me dt.07.07.2014 e miraton këtë :

RREGULLORE

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS 01. NR 011-5651 e dt: 20.12.2012

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi dhe qëllimi

Më këtë Rregullore përcaktohen lëmenjtë, kriteret dhe procedura e ndarjes së mjeteve të Buxhetit të Komunës së Gjakovës – Fondi për Transfere dhe Subvencione, për ndihmë momentale personave juridikë dhe fizikë, sipas procedurës së përshkruar në këtë Rregullore.

Neni 2

Përkufizimet

Komuna është nocioni për Komunën, i përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Kryetarja nënkupton Kryetaren e Komunës së Gjakovës .

Kuvendi nënkupton Kuvendin e Komunës së Gjakovës

Rregullore është emërtimi i Rregullores për ndarjen e subvencioneve

Student dhe nxënës nënkupton edhe emërtimin për gjininë femërore

Subvencionet - transferet janë pagesa financiare të njëhershme, të cilat i ndahen personit juridik apo fizik nga Buxheti i Komunës së Gjakovës

Person juridik nënkupton ndërmarrjen, entin, shoqatën, klubin etj, me identitet sipas të dhënave të regjistrave të personave juridikë

Person fizik nënkupton qytetarin me identitet sipas të dhënave të regjistrave të gjendjes civile

Neni 3

Kryetarja apo organet e administratës komunale të autorizuar nga Kryetarja, ndajnë mjete financiare për ndihmë momentale personave juridikë dhe fizikë, duke u bazuar në fondin për subvencione dhe transfere të Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin aktual dhe në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Subvencionet dhe Transferet

4.1 Subvencionet përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në llogari rrjedhëse për biznese private dhe ndërmarrjet publike. Pagesa e pakthyeshme është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesën.

4.2 Transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për institucionet jo profitabile, familjet dhe individët.

4.3 Për çdo pagesë të subvencionit apo të transferit duhet të ketë bazë të qartë juridike të bazuar në ligj, rregullore ose vendim të institucionit përkatës që i mundëson programeve specifike buxhetore lejimin e pagesës nga kjo kategori.

4.4 Subvencionet që i paguhen një individ apo një subjekti juridik, duhet të bazohen në një marrëveshje zyrtare mbi formën e subvencionimit.

4.5 Pagesat e subvencioneve dhe transferove duhet të bëhen përmes transfereve bankare.

4.6 Programet buxhetore duhet të mbajnë regjistra të detajuar të pagesave të subvencioneve dhe transferove të bëra, si dhe kthimeve nga këto pagesa. Programet buxhetore duhet të barazojnë këto shuma me raportet bankare dhe me SIMFK.

4.7 Përfituesit e subvencioneve dhe transferove janë të obliguar të raportojnë shpenzimin e shumës së përfituar nga Komuna dhe të sjellin dëshmi siç janë: Faturat, listat e përfituesve me nënshkrime dhe dëshmi të tjera sipas rastit, etj.

Neni 5

Subvencionet – ndihmat e njëanshme momentale për personat juridikë

Personat juridikë të certifikuar për veprimtari jofitimprurëse, institucionet dhe organizatat joqeveritare, klubet, shoqatat e ndryshme amatore në fushën e kulturës, arsimit, rinisë, sportit, artit, etj, si dhe personat fizikë mund të përfitojnë subvencione sipas kritereve të publikuara në media nga organet e administratës publike të Komunës, apo duke iu drejtuar për ndihmë Kryetares së Komunës.

Neni 6

Procesi i publikimit dhe shqyrtimit të kërkesave

6.1. Organet e administratës publike të Komunës i publikojnë shpalljet për ndarjen e subvencioneve për lëmi të caktuara nga fushëveprimi i tyre.

6.2. Të gjitha kërkesat për subvencione dorëzohen në zyrën e pranimi të Komunës dhe i drejtohen për shqyrtim komisionit, organit përkatës të administratës, apo Kryetares, varësisht nga organi i cili e ka publikuar shpalljen për ndarjen e subvencioneve, apo mbi bazën e kompetencës për vendosje lidhur me ndarjen e subvencioneve.

6.3. Komisionet për shqyrtimin e kërkesave të palëve për ndarjen e subvencioneve, formohen me qëllim të trajtimit të kërkesave të adresuara në kompetencë të organit

përgjegjës të administratës komunale dhe veprojnë sipas autorizimit të dhënë me vendim për formimin e këtij komisioni.

6.4. Organet e Komunës mund t'i trajtojnë edhe kërkesat e palëve, të cilat konsiderohen me interes për Komunën dhe nuk janë të ndërlidhura me shpalljet publike .

Neni 7

Kërkesat për përfitimin e subvencioneve duhen të jenë të kompletuara me këto dokumente:

- a. Projekti me arsyetimin përkatës, përshkrimi i aktiviteteve dhe specifikimi i shpenzimeve.
- b. Certifikata e regjistrimi të personit juridik, numri i llogarisë bankare dhe emri i bartësit të kartelës së llogarisë bankare.
- c. Raporti i aktiviteteve dhe i qarkullimit financiar vjetor.

Neni 8

Komisioni i caktuar për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve, i shqyrton kërkesat dhe ia dorëzon raportin e punës drejtorit të drejtorisë përkatëse, i cili mbi bazën e rekomandimeve nga raporti, ia përcjell dokumentacionin Kryetares për vendimmarrje.

Neni 9

9.1 Personat juridikë mund të përfitojnë subvencione komunale gjatë një viti kalendarik, deri në vlerën prej 15.000.€;

9.2 Për rastet e kërkesave të cilat e kalojnë vlerën prej 15.000€ , kërkesa duhet të parashtrahet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës .

9.3 Personat fizik mund të përfitojnë subvencione komunale gjatë një viti kalendarik deri në vlerën prej 3000€ .

Neni 10

Kryetarja merr vendim lidhur me kërkesën e personit juridik dhe fizik, duke e miratuar ndarjen e subvencioneve deri në vlerën e përcaktuar në nenin paraprak.

Neni 11

Kryetarja, në bazë të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit, mund të vendosë për ndarjen e subvencioneve për ndonjë aktivitet të ndërlidhur me grupet e punës së Kuvendit apo anëtarëve të Kuvendit, sipas mundësisë buxhetore të subvencioneve të zyrës së Kryetares.

Neni 12

Kriteret për ndarjen e subvencioneve për persona juridikë do të përcaktohen mbi bazën e programeve dhe synimeve për qeverisje të mirë komunale, duke u orientuar në subvencione të projekteve nga lëmi i Kulturës , Sportit , Bujqësisë , Arsimit, Shëndetësisë etj.

Neni 13 **Projektet nga lëmi i kulturës**

Projektet nga lëmi i kulturës subvencionohen për aktivitetet vijuese :

- a. Subvencionimi i projekteve për organizimin e festivaleve nga lëmi i artit muzikor, teatror, filmik, etj;
- b. Subvencionimi i koncerteve të muzikës artistike, koncerteve të ansambleve dhe grupeve të muzikës argëtuese, popullore, folklorike, etj;
- c. Subvencionimi i aktiviteteve për organizimin e simpoziumeve të ndryshme ;
- d. Subvencionimi i shoqatave dhe grupeve të artistëve, për hapjen e ekspozitave me vepra artistike ;
- e. Subvencionimi i kërkesave për botimin dhe promovimin e librave, si dhe për organizimin e Mitingut të Poezisë;
- f. Subvencionimi i kërkesave për shënimin e datave të ngjarjeve historike ;
- g. Subvencionimi i projekteve të Teatrit Profesionist të Gjakovës,, i projekteve të grupeve amatore të teatrove të kësaj Komune dhe grupeve të vallëzimit.
- h. Subvencionimi i projekteve të Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës .

Neni 14 **Projektet nga lëmi i sportit**

Projektet nga lëmi i sportit subvencionohen për aktivitetet vijuese :

- a. Përkrahja e qëndrueshme financiare e klubeve sportive të Komunës, përmes subvencionimit të shpenzimeve të kuotizimit – regjistrimit në federatat përkatëse për pjesëmarrje në gara të kampionatit të Republikës së Kosovës ;
- b. Bashkëpunimi me organizata dhe donatorë të ndryshëm, me qëllim të ngritjes së cilësisë së sportistëve dhe trajnerëve të cilët angazhohen në punë më të gjitha kategoritë e grupmoshave të sportistëve ;
- c. Subvencionimi i kërkesave të klubeve apo sportistëve të cilët garojnë si individë, për pjesëmarrje në gara kombëtare dhe ndërkombëtare;
- d. Përkrahja financiare e klubeve sportive të Komunës, të cilat gjatë historikut të tyre kanë treguar rezultate të mira dhe vazhdojnë me paraqitje të suksesshme, por nuk kanë mundur të sigurojnë donacione për zhvillimin e aktiviteteve të tyre;
- e. Subvencionimi i kërkesave të klubeve sportive për integrimin e komuniteteve minoritare në aktivitete sportive,
- f. Përkrahja financiare e Projekteve të OJQ-ve për persona me aftësi të kufizuara, , për aktivitetet e kulturës dhe sportit.

Neni 15

Komuna i subvencionon projektet dhe aktivitetet e rinisë së Komunës, të cilat janë të ndërlidhura me programet e punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për avancimin e vlerave dhe fuqizimin e aktiviteteve rinore të shkollave apo të Qendrës Rinore.

Neni 16

Projektet nga veprimtaria e bujqësisë

16.1. Projektet nga sektori i bujqësisë subvencionohen për aktivitetet vijuese:

- a. Subvencionimi i projekteve të fermerëve , shoqatave dhe kooperativave bujqësore nga lëmia e bujqësisë me fokus: Lavërtaria, pemëtaria , vreshtaria , perimtaria , blegëtoria , peshkimi, shpezëtaria dhe bletaria;
- b. Përkrahja financiare e projekteve të shoqatave , OJQ-ve dhe kooperativave bujqësore për zhvillimin e sektorit të bujqësisë përmes mbështetjes së organizimeve të : Panairëve , simpoziumeve, seminareve , punëtorive, punës praktike (fusha demonstruese) dhe zbatimit të standardeve të cilësisë (Glogal GAP, ISO 22.000 etj) ;
- c. Subvencionimi i projekteve në funksion të zhvillimit të bujqësisë, rritjes së fondit bujqësor në Komunën e Gjakovës si dhe rritjes së vlerës së buxhetit komunal për bujqësi, përmes bashkëpjesëmarrjes financiare me partnerët lokal dhe ndërkombëtar;
- d. Subvencionimi i projekteve për pyllëzimin e hapësirave me fidanë të rinjtë dhe mbrojtja e hapësirave pyjore nga degradimi , duke u bazuar në Ligjin mbi Pyjet .

16.2 Shqyrtimi i kërkesave për subvencione nga ana e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural do të bazohet në këto kritere:

- a. Ndarja e subvencioneve për fermerët , shoqatat apo kooperativat bujqësore duhet të realizohet duke respektuar ndarjen proporcionale të tyre sipas regjioneve të Komunës së Gjakovës (Gjakova, Hasi, Reka e mirë , Reka e keqe dhe Dushkaja) . I njëjti kriter vlen edhe për mbështetjen me subvencione të projekteve të shoqatave dhe kooperativave bujqësore, në rastet kur mbështeten projektet e tyre.
- b. Do të subvencionohen kërkesat për aplikim / projektet e fermerëve, shoqatave të fermerëve, kooperativave bujqësore të cilat përmbushin kriterin e pjesëmarrjes së fituesit në vlerë prej 20 % të vlerës së përgjithshme të subvencionit, përveç në rastet kur në thirrjen për aplikim është e specifikuar ndryshe. Kjo bashkëpjesëmarrje në vlerën totale të përfitimit do të jetë në funksion të rritjes së fondit të subvencioneve .
- c. Përparësi kanë projektet zhvillimore që gjenerojnë numër më të madh të punësimit, rrisin fondin bujqësor në komunë dhe zbatojnë standardet e cilësisë. Projektet që udhëhiqen nga femrat dhe të rinjtë po ashtu kanë përparësi .
- d. Përzgjedhja e projekteve dhe përfituesve bëhet nga komisioni i formuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Komisioni do të përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët e përfaqësojnë Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural , Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe shoqërinë civile (ekspertë të pavarur, shoqata të fermerëve etj) .

16.3 Monitorimi i subvencioneve nga ana e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim

Rural:

- a. Fermerët, shoqatat e fermerëve apo kooperativat bujqësore obligohen që në periudhën kohore prej tri vjetëve nga data e përfundimit të subvencionit, të raportojnë në baza vjetore në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për shfrytëzimin e subvencioneve dhe rezultatet e arritura si rezultat i përfundimit; b. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural gjatë periudhës së monitorimit, ka të drejtë të vizitoj përfundimet e subvencioneve dhe të kërkoj informacione rreth shfrytëzimit të tyre;
- c. Procesi i monitorimit dhe veprimet të tjera me interes për DBPZHR, duhet të specifikohet në marrëveshjet e nënshkruara në mes të përfundimit dhe organeve komunale.

Neni 17

Subvencionet – ndihmat e njëanshme momentale për personat fizikë

Kryetaria dhe organet e autorizuar të administratës publike komunale, ndajnë ndihma nga fondet e subvencioneve të Buxhetit të Komunës së Gjakovës, sipas kërkesave të palëve për mbulimin e shpenzimeve të shërimin, përballimin të varfërisë së skajshme, për raste emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, për ndarjen e bursave të studentëve dhe të nxënësve të cilët mësojnë në shkollat speciale, si dhe për rastet e tjera të natyrës emergjente, për shpenzime të varimit të qytetarëve etj. të cilat mund të trajtohen nga Kryetaria.

Neni 18

Komuna i subvencionon projektet për përkrahje financiare të ndërlidhura me gëshjen gjinore dhe për integrimin e femrave në shoqëri, me theks të veçantë për rinintegrimin e grave të cilat kanë pësuar dhunë, si dhe kërkesat e grupit të grave anëtare të Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Neni 19

Kriteret për ndarjen e subvencioneve për ndihmën e personave fizikë janë të ndërlidhura me programet e punës së drejtorive të Komunës, të cilat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe avancimin e vlerave në lëmin e arsimit, bujqësisë, kultures, shëndetësisë, mirëqenies sociale, sportit, artit, rinisë etj.

Neni 20

Subvencionet në lëmin e arsimit

20.1 Komuna ndan subvencione në formë të bursës për studentë dhe nxënës me aftësi të kufizuara sipas kriterëve të caktuara nga Drejtoria për Arsim, për profilin e fakulteteve dhe shkollave speciale, numrin e bursave dhe lartësinë e vlerës së bursës, ndërsa këto kritere do të realizohen përmes procedurës për ndarjen e bursës.

20.2. Drejtoria për Arsim e parashtron propozimin në Bordin e Drejtorëve ose në zyrën e Kryetarit të Komunës, për miratimin e vendimit për publikimin e konkursit në gazeta dhe medime të tjera, për ndarjen e bursave për studim dhe mësim në vitin përkatës akademik dhe shkollor.

20.3. Në konkurs do të theksohen të dhënat vijuese:

- a. Profili i fakulteteve dhe numri i bursave ;
- b. Profili i shkollave speciale dhe numri i bursave ;
- c. Afati për pranimin e kërkesave ;
- d. Dokumentet e kërkuara, përfshirë këtu:
 - Vërtetimin për regjistrim në fakultete apo shkolla speciale ;
 - Certifikatën e notave
 - Certifikatën e gjendjes ekonomike dhe familjare .
 - Dokumenti që nuk është përfitues i bursës universitare

20.4. Kërkesat e pakompletuara me dokumente përkatëse , nuk do të merren në shqyrtim .

Neni 21

Drejtoria e Arsimit e formon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e bursave dhe pas mbylljes së afatit të konkursit, ky komision në bashkëveprim me drejtorin e kësaj drejtorie, e kryen procesin e shqyrtimit të kërkesave dhe e harton raportin e punës, të cilin me rekomandime përkatëse ia përcjell Kryetares për miratimin e vendimeve për ndarjen e bursave.

Neni 22

Kriteret për ndarjen e bursave

22.1 Kriteret për ndarjen e bursave janë si në vijim:

- a. Nota mesatare prej 9 – 10 në fakultete, ose suksesi i shkëlqyeshëm – 20 pikë.
- b. Fëmijët pa prind (Fëmijët e Dëshmorëve, Martirëve dhe Invalidëve të Luftës) -- 25 pikë
- c. Nota mesatare prej 8 – 9 në fakultete, ose suksesi shumë mirë – 15 pikë.
- d. Nota mesatare prej 7 – 8 në fakultete, ose suksesi i mirë -- 10 pikë.
- e. Personat me aftësi të kufizuara - 15 pikë
- f. Rastet me gjendje të vështir ekonomike dhe sociale - 15 pikë.

22.2 Në kushtet e barabarta të vlerësimit të kriterëve të përshkruara në nenin 22.1, përparësi kanë fëmijët e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës, viktimave të luftës dhe të familjeve që kanë dy apo më tepër studentë.

Neni 23

Komisioni për shqyrtimi e kërkesave për ndarjen e bursave, e bënë publikimin e listës së kandidatëve të cilët janë përzgjedhur si përfitues të bursës.

Neni 24

Kandidatët e pakënaqur me vendimin e Komisionit për ndarjen e bursave, mund të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes dhe publikimit të rezultateve të përfitueseve të bursës, pranë komisionit ad-hoc që do të formohet nga Kryetari i Komunës për shqyrtimin e këtyre ankesave.

Neni 25

Kandidatët të cilët përfitojnë bursë nga Buxheti i Komunës , e nënshkruajnë kontratën me Drejtorinë e Arsimit , me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, lartësia e bursës, mënyra e pagesës dhe kriteret për vazhdimin e bursës, deri në përfundimin e studimeve në fakultete, përkatësisht përfundimin e shkollimit në shkollat për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta .

Neni 26

Subvencione në lëmin e shëndetësisë

Komuna ndan subvencione për ndihmën e qytetarëve për përballimin e shpenzimeve të shërimit, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale .

Neni 27

27.1. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale bën publikimin e shpalljes për pranimin e kërkesave të qytetarëve të sëmurë për ndarjen e ndihmave në lëmin e shëndetësisë , e përgatit formularin e aplikimit me të dhënat përkatëse, i cili dorëzohet në zyrën pritëse të Komunës dhe njëherësh e formon Komisionin për shqyrtimin e këtyre aplikacioneve .

27.2 Në varësi nga fondi i mjeteve të dedikuara për subvencione në lëmin e shëndetësisë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale mund të përsërisë gjatë vitit kalendarik shpalljen për ndarjen e subvencioneve .

27.3. Ndarja e subvencioneve në lëmin e shëndetësisë do të aplikohet deri në miratimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore.

Neni 28

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndihma në lëmin e shëndetësisë, harton një raport pune i cili i dorëzohet drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ndërsa ai i rekomandon Kryetares së Komunës që të miraton vendimet për ndarjen e subvencioneve sipas kriterëve të përcaktuar në këtë raport .

Neni 29

29.1. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i shqyrton edhe kërkesat e qytetarëve të Komunës për ndihmë financiare për rastet emergjente shëndetësore, e që janë në gjendjes të vështirë ekonomike dhe sociale , ndërsa vendimin për ndarjen e ndihmave e miraton Kryetarja .

29.2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të përkujdesen edhe për realizimin e procesit të ndarjes së subvencioneve për ndërtimin, përkatësisht përfundimin e objekteve të banimit të qytetarëve të cilët nuk e kanë zgjidhur problemin e strehimit, duke i mbështetur me mjete financiare deri në vlerën maksimale prej 2.000€.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të realizon procesin e ndarjes së këtyre ndihmave sipas modelit të procesit për ndarjen e ndihmave në shëndetësi, i cili përkufizohet në nenin 27 të kësaj Rregulloreje dhe në varësi të vlerës së mjeteve financiare të buxhetit komunal, e cila dedikohet për lëminë e strehimit dhe përfundimit të objekteve të banimit të qytetarëve .

Neni 30

Subvencione në lëmin e bujqësisë, pylltarisë, dhe zhvillimit rural

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i shqyrton kërkesat e qytetarëve për ndarjen e subvencioneve nga fushëveprimi i kësaj Drejtorie, duke u përkujdesur për trajtimin e këtyre kërkesave në harmoni me të dhënat e përshkruara në nenin 16.1 dhe 16.2 të kësaj Rregulloreje, me të cilin rregullohet procesi i ndarjes së subvencioneve për personat juridik.

Neni 31

Subvencione në lëmin e kulturës, rinisë dhe sportit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport i shqyrton të gjitha kërkesat e qytetarëve të Komunës , të cilët kërkojnë ndihmë financiare për realizimin e projekteve në lëmin e artit figurativ , teatrit , muzikës , filmit , letërsisë, kërkesat për programet e aktiviteteve të rinisë, si dhe kërkesat e lëmit të sportit dhe përkujdeset për procesin e ndarjes së subvencioneve në harmoni me nenet 13, 14, dhe 15 të kësaj Rregulloreje.

Neni 32

Kryetarja i miraton vendimet për ndarjen e subvencioneve për projektet e qytetarëve nga lëmenjtë e përshkruar në nenin 31, duke u bazuar në rekomandimet përkatëse të drejtorit dhe Komisionit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 33

Subvencione për situata emergjente dhe raste të vdekjes

Kryetarja e lejon ndarjen e subvencioneve për persona dhe familje me gjendje të varfër ekonomike, për rastet emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore e të ngjashme, për sëmundje të rënda që kërkojnë trajtim i menjëhershëm, pastaj për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të personave, familjet e të cilëve janë në gjendje të rëndë ekonomike, si dhe për raste të tjera të cilat Kryetarja i konsideron të arsyeshme për ndarjen e ndihmës përmes subvencioneve komunale.

Neni 34

34.1 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim i shqyrton kërkesat për ndihmë të qytetarëve të komunitetit minoritarë, si dhe kërkesat që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile, kërkesa këto që kanë të bëjnë me projektet për zhvillimin dhe integrimin e komuniteteve pakicë të Komunës së Gjakovës .

34.2 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim i shqyrton edhe kërkesat për rastet sociale për rregullimin e ambienteve të banimit (rregullime të vogla brenda shtëpive dhe renovime të pullazeve në raste të veçanta të shkaktuara nga zjarri apo nga forca e natyrës), si dhe kërkesat për raste sociale të personave dhe familjeve të rrezikuara, për shpërndarjen e ushqimit dhe të ndihmave humanitare .

34.3 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim i shqyrton kërkesat për ndihma të qytetarëve të komuniteteve minoritare, ndërsa Kryetarja i miraton vendimet për ndarje të subvencioneve në harmoni me rekomandimet e shefit të kësaj zyreje dhe të komisioneve përkatëse të autorizuar për trajtimin e këtyre kërkesave.

Neni 35

Kryetari mund t'i propozojë Kuvendit miratimin e vendimeve për ndarjen e ndihmave përmes subvencioneve, për vlera me të mëdha se vlera e caktuar me nenin 9, paragrafi 9.1,9.2 dhe 9.3 të kësaj Rregulloreje.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Me miratimin e kësaj Rregulloreje, pushon se vepruari Rregullorja për Ndarjen e Bursave, e miratuar në Kuvendin e Komunës së Gjakovës me dt. 18.12.2003 dhe e evidentuar me nr. 04-610/2003 dhe Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve 01 nr.011-5651 e dt: 20.11.2012, si dhe vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-1209 i dt: 28.02.2013

Neni 37

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të përkujdeset Kryetarja , Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe drejtoritë të cilat janë të ndërlidhura me procesin e ndarjes së subvencioneve.

Neni 38

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvend, dhe pas nënshkrimit të vendimit për miratimin e saj nga Kryesuesi i Kuvendit .

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01. nr. 011-11268/2014

Dt: 07.07.2014



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Dr. Luan Goia